

Mbajeni Fëmijën Tuaj të Sigurt Online

Një udhëzues i shpejtë për prindërit në epokën dixhitale

Rrjetet Sociale

Mësoni sjellje të shëndetshme online: Ndhimoheni fëmijën tuaj të kuptojë se çdo gjë që poston në internet mund të mbetet aty përgjithmonë. Inkurajojini të jenë të sjellshëm, të mendojnë para se të postojnë dhe të pyesin veten nëse diçka që shohin është e vërtetë apo e rreme.

Mbani hapur bisedën: Tregojini fëmijës suaj se mund të vijë të flasë me ju nëse diçka online e bën të ndihet në siklet. Krijoni një hapësirë ku ai/ajo ndihet i sigurt për të ndarë përvojat e veta.

Vendosni cilësimet e duhura:

- Shumë telefona dhe tableta kanë mjete që ndihmojnë prindërit të vendosin kufij për kohën e ekranit, të bllokojnë përmbajtje të caktuara dhe të kontrollojnë cilat aplikacione mund të shkarkohen.
- Sigurohuni që profili i fëmijës suaj të jetë i vendosur me moshën e saktë që aplikacioni të filtrojë përmbajtjet e papërshtatshme.
- Fikni shërbimet e vendndodhjes përveçse kur janë me të vërtetë të nevojshme – dhe vetëm me lejen tuaj.

Videolojërat

Kontrolloni vlerësimet: Përpara se fëmija juaj të luajë një lojë, shikoni vlerësimet e asaj loje sipas moshës dhe përmbajtjes. Sigurohuni që loja të jetë e përshtatshme për moshën e tij/saj.

Vendosni kufizime në kohë: Ndhimoheni fëmijën tuaj të balancojë lojërat me shkollën, gjumin, ushtrimet fizike dhe kohën me familjen. Inkurajojini të kenë edhe hobi e aktivitete të tjera.

Dijeni me kë po luajnë: Nëse fëmija juaj luan online, informohuni me kë po ndërvepron. Flisni për të qenë sportist i mirë, si të dallojnë ngacmimin dhe bullizmin kibernetik (online) dhe si të bllokojnë e raportojnë sjellje të papërshtatshme.

Mësimi mbi Privatësinë

Mësoni praktikat për fjalëkalime të forta që herët: Tregojini fëmijës tuaj si të krijojë fjalëkalime të forta duke përdorur një kombinim shkronjash, numrash dhe simbolesh. Shpjegojini se fjalëkalimet e thjeshta nuk janë të sigurta dhe se përdorimi i të njëjtit fjalëkalim për gjithçka mund të jetë i rrezikshëm.

Bisedoni për mbajtjen private të fjalëkalimeve: Mësojeni fëmijën tuaj të mos i ndajë fjalëkalimet me askënd, madje as me shokët. Ndhimoheni të kuptojë se nëse dikush futet në llogarinë e tij/saj, mund të humbasë qasjen ose informacioni personal të shpërndahet apo keqpërdoret.

Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/digitalcitizenship